



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 392 Prot.

Tiranë, më 11.06 2015

**VENDIM Nr. 50 datë 04.06.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, të datës 04.06.2015, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Apolonia"* miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtues Prof. Faik Drini dhe Prof. Jean-Luc Lamboley,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Apolonia"* paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, drejtuar nga Prof. Faik Drini dhe Prof. Jean-Luc Lamboley, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Përfundimi i studimit të materialit, me qëllim dorëzimin e dorëshkrimeve për botim.
  - Ndërhyrjet në terren do të kufizohen në disa gjurmime verifikuese apo punime valorizuese: a) në zonën e qytetit të sipërm; b) në zonën e sektorit G të qytetit të poshtëm; c) në sektorin e murit rrethues lindor.
- II. Proceset e hulumtimit arkeologjik do të kryhen sipas periudhave kohore të parashikuara në projektin e paraqitur, brenda vitit 2015.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)